




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës /Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 44 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 6 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit të Komunës, neni 38 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, i datës 03.12.2008, dhe nenit 9 i Rregullores së Punës së Kuvendit, si dhe në pajtim me rregullat e procedurës për mbajtjen e mbledhjeve, Kryesuesja e Kuvendit:

T H Ë R R E T

Mbledhjen e Jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës - Skenderaj, e cila do të mbahet me datë 15.01.2024, (ditë e hënë), duke filluar nga orën 10:00, në Sallën e Kuvendit Komunal.

Mbledhja do të ketë këtë:

REND DITE

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Propozim/kërkesë për përkrahjen e 15 janarit Ditës të Përkujtimit të Gjenocidit ndaj shqiptarëve në Kosovë, (Prezanton Kryetari i Komunës **z. Fadil Nura**).



KRYESUESJA E KUVENDIT
znj. Adelina Spahiu

Adelina Spahiu



QENDRA
GJENOCIDI NË KOSOVË
PLAGË E HAPUR

GJENOCIDI NË KOSOVË – PLAGË E HAPUR
1200 Genève
E-Mail: info@kosovogenocide.com
Online: www.kosovogenocide.com

Republika e Kosovës
Asociacioni i Komunave të Kosovës
Rr. "Gustav Mayer" Nr.5,
10000, Prishtinë

Kërkesë

I nderuari i Kryetar i Asociacionit të Komunave të Kosovës, z. Agim Aliu
I nderuari i Drejtor ekzekutiv i Asociacionit të Komunave të Kosovës, z. Sazan Ibrahim

Më 16 maj 2019, Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi Rezolutën nëpërmjet të cilës shpalli 15 janarin Ditë të Përkujtimit të Gjenocidit ndaj shqiptarëve në Kosovë.

Një çerekshekulli më parë, në vitin 1998-1999 forcat serbe kanë vrarë në mënyrë sistematike mbi dhjetë mijë civilë shqiptarë, kanë dëbuar shumicën e popullsisë nga Kosova, kanë shkatërruar objekte të arsimit e të trashëgimisë kulturore shqiptare si dhe kanë dhunuar seksualisht mbi njëzet mijë gra e burra të përkatësisë shqiptare. Përgjegjësia për këto akte të tmerrshme bie mbi shtetin serb si planifikues e zbatues i gjenocidit kundër shqiptarëve.

Më 15 janar 2024 bëhet një çerek shekulli nga krimi i gjenocidit në Kosovë!

Ngritja e zërit për arritjen e drejtësisë është një obligim yni kombëtar, në mënyrë që të sensibilizojmë botën demokratike për njohjen dhe arritjen e drejtësisë për gjenocidin ndaj shqiptarëve të Kosovës.

Ftojme Asociacionin e Komunave të Kosovës që në këtë përvjetor simbolik të çerekshekullit të krimit të gjenocidit, të organizohen seanca solemne për të nderuar viktimat e krimit të gjenocidit gjatë luftës 1998-1999.

Gjenevë, 28 dhjetor 2023

Qendra "Gjenocidi në Kosovë – Plagë e Hapur"

Bardhyl Mahmuti

Kryetar

Adnan Asllani

Zëvendër Kryetar